

U-21 fiton kunder Hungarise

nga Administrator

E hënë, 28 Mars 2016 21:22



U-21 e Shqipërisë ka fituar kundër ekipit të Hungarisë me rezultatin 2-1. Ekipi ynë kombëtar ka arritur të përmbys avantazhin e hungarezëve me anë të Manaj dhe Prenges. Lojtaret tanë e fillojnë mirë takimin dhe përpiqen të marrin frenat e lojës por pa arritur të kalojnë në avantazh. Pjesa e parë mbaron me rezultatin e barabartë 0-0.

Ekipi hungarez e fillon me mirë pjesën e dytë dhe në minuten e 55 kalojnë në avantazh pas një "hutimi" të mbrojtës tonë. Autor i golit për ekipin hungarez është Gera. Lojtaret e kombëtares tanë arrijnë të gjejnë shpejt golin e barazimit me anë të Manaj, minuta e 68, gjithçka në barazpeshë. Me golin e barazimit, lojtaret tanë marrin frenat e lojës dhe kërkojnë me ngulm golin e avantazhit. Gol i cili do të vijë në minuten e 68 me anë të Prenges. Lojtari i Skenderbeut krosin në zonë dhe Prenga i pambuluar e ka të lehtë të përmbysë rezultatin. Në minutat e mbetura, Shqipëria menaxhon rezultatin duke marrë 3 pike të rëndësishme.

Pas kësaj fitore, Shqipëria arrin të mbajë vendin e dytë me 12 pike të grumbulluara në 8 ndeshje.

Ndeshjet e radhës për ekipin tonë janë kundër Greqisë me datë 2 Shtator dhe kundër Izraelit me datë 6 shtator.